

# Tumankuqe

# Süd – Çam

1. // Tumankuqe moj bel hollë.  
 Ma bën me si ma bën me dorë. //  
 // Ma bën me si ma bën me dorë.  
 Të pret djali në oborr. //
  
2. // Nek shtëpia me dërrasa.  
 Dil moj kaleshkë se plasa. //  
 // Dil moj dil moj në dritare.  
 Vajze Çame lozonjare. //
  
3. // Moj jelek-verdha veshur-o.  
 Moj vije duke qeshur-o. //  
 // Un' thashë se vije nek unë.  
 Ti veje ku keshe punë. //
  
4. // Moj jelek-verdha me mëndafshë.  
 Moj hidhe vallen me javashë. //  
 // Hidhe vallen me javashë.  
 Dhe shoqet të vinë nga pas-ë. //